



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 125 , datë 2.2.2008

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN DAJÇ, TË
QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :


1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Dajç, të qarkut të Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 41 (dyzet e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



BUJAR NISHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1128, datë 13.11.2009

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN,
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DAJÇ, TË
QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :


1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dajç, të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dajç, të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.125, datë 2.2.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dajç, të qarkut të Lezhës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dajç për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



LULZIM BASHA

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-8	Varreza publike.	Në pronësi
9	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik .	Në pronësi
14-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
23-46	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
50,54,58,61,64,68,73,76,79,83,87,91,94,120	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (kanale të trata dhe toka jo produktive).	Në pronësi
97-111,145-152	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike.)	Në pronësi
116-119	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (toka produktive)	Në përdorim
121-130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

MINISTRI

LULZIM BASHA

Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSMINISTRI

Ferdinand PONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 707 , datë 12.10.2011

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, OË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS DAJÇ, TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:


1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dajç, të qarkut të Lezhës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 42 (dyzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Dajç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



BUJAR NISHANI

4 - 8	Varreza publike	Në pronësi
9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shërbimet publike.	Në pronësi
10 - 13, 153-154	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
14 - 21	Prona që përdoren pr realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
23 - 46	Prona që përdoren për ushtrimin e profesioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. (objekte bujqesore)	Në pronësi
50,54,58,61,64,68,71,73,76,79, 83,87,91,94,120	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produtive).	Në pronësi
97-111, 145-152	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
116 - 119	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produtive).	Në përdorim DAMT e komunës së bashku me atë të qarkut Lezhë ka vene ne dispozicion te AKKP-së nga kjo komunë sipërfaqen prej 48.57. Kjo sipërfaqe është dorëzuar në AKKP bashkë me dokumentacionin shoqërues.
121 - 130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës - kanalizimeve.	Në pronësi

MINISTRI
BUJAR NISHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 606 , datë 5.9.2012

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.707, DATË 12.10.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI APO NË
PËRDORIM TË KOMUNËS DAJÇ, TË QARKUT TË LEZHËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave


V E N D O S I:

1. Në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të komunës Dajç, bashkëlidhur vendimit nr.707, datë 12.10.2012, të Këshillit të Ministrave, shtohet lista me 1 (një) fletë, që përfundon me numër rendor 2 (dy), e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të

Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dajç, e qarkut të Lezhës, për
zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA


MINISTRI MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE



FATMIR MEDIU

MINISTRI I BRËNDSHËM

FLAMUR NOKA




Njësia Qeverisjes Vendore **DAJÇ**
Qarku, **LEZHË**

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
155-156	Kullote	Pronesi

FATMIR *MEDIU*
MINISTËR



FLAMUR *NOKA*
MINISTËR



2.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE.

Per nje shtese ne listen perfundimtare te pronave te palujshme. miratuar me VKM nr. 707 off. 12.10.2011

Institucioni i Pushtetit Qendror. M.M.P.A.U

Komuna Dajç

Fusha e perdorimit te prones:



Siperfaqe Kuollesore 294 ha

Kryetari i Njesise se Qeverdimit

Gjergj Doçi

DREJTORI I SHERBIMEVE PUNORIMIALE

Besnik LLESHI



Nr	Nr. pasurise Sips vkm	Emergjesa e Ekom.pyjore	Emri iesa e Ngastes Vendndodhja (sips Emergjeses popullore	Numeri i Nrgastr es	Destinacioni	Siperf. ha	Funksioni Per te cilen Perdoret pronu	Institucioni Enti me Pergjegjesi administrative	Institucioni i Entit perdorues Statusi Juridik i perdoruesit	10
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1-	155	Mali i Kakarrigjit Zadrime	Mali i Kakarrigjit Kisha e Dajqit	15/h	Kuollote	291	Per Kuollote	M.M.P.A.U	Komuna Dajç	Punohet me Plane Inventarizimi te vitit 1985
2-	156			74	Kuollote	3	Per Kuollote	M.M.P.A.U	Komuna Dajç	Punohet me Plane Inventarizimi te Kullodave te vitit 1992

Totali : Kuollita 294